

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

“Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”

1. Titulli i projektaktit

“Projektligji “Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Më 20 shkurt 2024, në orën 11:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, u zhvillua takimi i grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, i ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 22, datë 19.01.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”.

Në hapje të këtij takimi, Kryetari i grupit të punës vlerësoi nismën për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e të dhënave të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, duke rikujtuar detyrimet që rrjedhin nga urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 22, datë 19.01.2024. Grupi i punës u përqëndrua për realizimin brenda afatit të detyrave të Urdhrit, si mëposhtë:

- a) të vendosë dhe miratojë përmbajtjen e raportit të vlerësimit (RIA);
- b) të miratojë tabelat e përputhshmërisë për çdo acqui të BE që synohet të përafrohet;
- c) t’i propozojë ministrit çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e këtij projekt akti.

Në vijim, referuar Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 80, datë 07.05.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, u thirr mbledhja e parë të Grupit të Punës dhe të Grupit Teknik të Punës, më datë 31 maj 2024, ora 12:00 – 13:00, në mjediset e Ministrisë së Brendshme.

Në këtë mbledhje u diskutua përmbajtja e draftit paraprak të projektligjit, u vendosën afatet për hartimin e tabelave të përputhshmërisë, RIA-s si dhe relacionit shpjegues.

Mbledhjet e tjera me qëllim finalizimin e praktikës u zhvilluan me datë 20 shkurt 2024, si dhe datë 01 tetor 2024, nga ku u diskutuan me gjerë dispozitat e projektaktit, dhe aktet shoqëruese.

Projektligji u publikua në RENJKP në datë 4 nëntor 2024 deri në 2 dhjetor 2024, në respektim të afatit prej 20 ditë pune duke marrë 290 shikime dhe 0 komente.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 22, datë 19.01.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike) të anëtarëve të grupit të punës dhe ekspertëve të jashtëm.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtorja e Përgjithshme për Çështjet e Brendshme në MB;

- Drejtoria e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Delegacioni i BE;
- Koordinator i për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/ I refuzuar)</i>	<i>Justifikimi</i>
Referenca në vendimin e Gjykatës së Drejtësisë	Për PNR, projektligji të marrë parasysh vendimin paraprak të Gjykatës së Drejtësisë (GJED) për çështjen C-817/19, me të cilin Gjykata ka dhënë një interpretim detyrues për mënyrën në të cilën Direktiva PNR duhet të transpozohet nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe të zbatohet nga autoritetet e tyre.	Delegacioni i BE në Shqipëri	Pranuar, projektligji i “Për përpunimi e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë” është në përputhje me vendimin paraprak të Gjykatës së Drejtësisë (GJED) për	Nisur nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë (GJED) për çështjen C-817/19, si dhe për afrimi me legjislacionin e BE-së, është vlerësuar referenca në këtë vendim, mbi disa aspekte procedurale që lidhen konkretisht me afatin e ruajtjes së të dhënave.

			çështjen C-817/19	
Ruajtja e të dhënave udhëtimit	mbi ruajtjen e të dhënave PNR (ku Gjykata Evropiane e Drejtësisë kërkon të vendoset një lidhje objektive për ruajtjen e të dhënave deri në maksimum 5 vjet,	Delegacioni i BE-së në Shqipëri	Pranuar. Në nenin 15, parashiko het se: 1. Të dhënat e udhëtimit, të transmetuara pranë SIU nga transportuesit ruhen në bazën e të dhënave në sistemet e automatizuara të SIU, për një periudhë pesëvjeçare nga transmetimi i tyre.	Përputhmëri me direktivat e BE-së të lidhura me informacionin pasagjerit dhe të dhënat PNR.

<p>Miratimi i një rregulloreje të re API</p>	<p>Për API, memorandum i shpjegues i referohet direktivës ekzistuese API (Direktiva e Këshillit 2004/82).</p> <p>Ju lutemi vini re se dy Rregullore të reja API sapo janë miratuar dhe do të publikohen së shpejti. Ata do të shfuqizojnë dhe zëvendësojnë Direktivën e mësipërme. Në veçanti, Rregullorja API për zbatimin e ligjit do të rregullojë mbledhjen dhe transferimin e të dhënave API me qëllim të luftës kundër krimit të rëndë dhe terrorizmit.</p>	<p>Delegacioni i BE-së në Shqipëri</p>	<p>Projektligji është hartuar në përputhje me direktivën ekzistuese API (Direktiva e Këshillit 2004/82).</p>	<p>Deri në këto momente, nuk kemi një rregullore të re të publikuar për të dhënat AP dhe PNR.</p>
--	---	--	--	---